



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

Data 10.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Vajra dhe lubrifikant për automjete

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Vajra motorike – 09211100-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 397 500 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatesisht në vleren:27 950 (njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët Ekonomik pjesmarrës në tender duhet të jenë pajisur me çertifikatë, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 ose e perditesuar “Sistem menaxherial të cilësisë” për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme), e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 45001-2018 ose e perditesuar “Sistem menaxherial të cilësisë” për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme), e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

. Të gjitha çertifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një standard ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (QMS) dhe është i kërkuar dhe për industrinë e vajrave dhe lubrifikantëve të cilat lidhen me cilësinë dhe përputhshmërinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen. Sigurimi i cilësisë së produktit në industrinë e vajrave dhe lubrifikantëve, është thelbësorë pasi siguron që produktet të kenë cilësi të gendrueshme për të përmbushur kërkesat e përdoruesve dhe specifikimet teknike. ISO 9001:2015 kërkon që proceset e prodhimit të jenë të kontrolluara kjo ul mundësinë e defekteve në produktet përfundimtare, që në industrinë e vajrave dhe lubrifikantëve është kritike për të parandaluar demtimin e makinerive dhe uljen e kostove që lidhen me rikthimin e produkteve ose riparimin e dëmeve.

ISO 14001 shërben për të ndihmuar në menaxhimin në mënyrë efektive ndikimin e tyre në mjedis dhe të përmirësojnë performancën mjedisore. Ky standard është një sistem menaxhimi mjedisor që ka për qëllim: Identifikimin dhe kontrollin e ndikimeve mjedisore: ISO 14001 ndihmon në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullore mjedisore, duke ulur rrezikun e ndotjeve..

Në përputhshmeri me kërkesat ligjore Industria e vajrave dhe lubrifikantëve është e rregulluar me ligje dhe standarde për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe emetimeve toksike. ISO 14001 siguron që kompania të jete në përputhje me rregulloret mjedisore lokale dhe ndërkombetare, për të shmangur ndotjet e shumta në mjedis.

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 2, germa (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, germa (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës, referuar nenin 43 pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e **Hapur e Thjeshtuar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare

vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 333.196 (treqind e tridhjetë tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i se njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i se njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë

përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fizikisht mostrat për çdo artikull të cilat duhen të jenë me mbyllje dhe etikete fabrike (jo mbyllje të subjektit ofertues)

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e AK.
- Cdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". ku shprehet specifikisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) mostra të mallit, ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK . Autoriteti kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike nëpërmjet paraqitjes së mostrave krijon mundësinë e kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim), të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruara në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Ky kriter konsiderohet i nevojshëm dhe i rëndësishëm për vlerësimin e ofertës teknike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

2.3.3 Për të gjitha produktet Operatorët Ekonomik të paraqesin raport Analize të leshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike (nga ISHTI ose laborator i akredituar), që vërteton pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Kjo analize verteton pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike. Ky raport është i detyrueshem per të siguruar qe cilesia dhe perberja e produkteve si vajrat dhe lubrifikantet perputhen me standardet e kerkuara

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizimi i prodhuesit nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponoje Licencën e kategorisë VIII 1. A3 “ Per vajra Lubrifikante”

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar dhe për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

Si dhe Bazuar dhe ne vendimin “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” nr. 538 date 26.05.2009 pika VIII 1.A a) “Tregetimi me shumice i naftes, gazit, nenprodukteve perfshire ato bio si dhe lendet djegese” me kodin VIII.1.A

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues për mallin objekt prokurimi, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të mallrave objekt prokurimi dhe skedat teknike të mjetit. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mjetit referuar çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. (ne te gjitha rastet katalogu duhet i përkthyer në gjuhën shqip).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku merr përsipër furnizimin e mallit te kerkuar ne objektin e prokurimit,prane Autoritetit Kontraktor brenda afateve te kerkuara.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , Neni 77, pika 1 gërma ”c” si dhe të nenit 40 pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në magazinën e blerësit ne perputhje me kushtet e lëvrimit të mallit

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te shoqeroje me nje liste te pergjitheshme ku te specifikohen te dhenat si vijon

Nr	Emertimi i artikullit qe operatori ekonomik oferton	Njesia	Sasia	Emertimi i kompanise Prodhuese	Emertimi i katalogut	Nr i faqes ku ndodhet produkti ne katalog	Linku i produktit ne internet	Standarti i cilesise

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , Neni 77, pika 1 gërma ”c” si dhe të nenit 40 pika 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në magazinën e blerësit ne perputhje me kushtet e lëvrimit të mallit

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. Specifikimet teknike për Vajra dhe Lubrifikant për Automjete.

- 1.Vaj Hidraulik HV 46: DIN 51524-2(HLP) DIN ISO 6743-4 (HM).
- 2.Vaj motorri 2T: API TC, CEC TSC-3
3. Vaj motorri SAE 20W-50: API CF-4/CF/SG
4. Vaj kambio SAE 80W90: API GL-4
5. Vaj motorri 10W-40: SAE API CI-4/SL, ACEA E7/A3/B4
6. Vaj motorri SAE 5W-30: API SN/CF, ACEA C2, A5/B5, PSA B71 2290,Fiat 9.55535-S1.
7. Vaj motorri SAE 15W-40: API CF-4/CF/SH, ACEA E-2, ose API CG-4/CF-4/CF/SH, ACEA E-2
8. Vaj motorri SAE 75W-80SL: Vaji Fully Syntetik per Kamio. Iveco SAE 75W80SL, Iveco, Man 341-E3/Z4,Volvo 97305,ZF TE-ML 01L, 02L, 16K, 08
9. Vaj Kambio Renault Duster 2020 : PSA AL-4 ose RENAULT AJ-8, RENAULT AJ0.
- 10.Vaj për grup timoni: G004 000, G002 012, G052146,MB 236.3/345.0

1. Vaj hidraulik HV 46	Vaj Hidraulik 46, DIN 51524-2(HLP) DIN ISO 6743-4 (HM). Amballazh 20 litër Densiteti 15°C të jetë 0.850-0.880 g/cm ³ . Përmbajtje uji nuk ka. Viskoziteti në 40°C 44.8-46.5 mm ² /s. Viskoziteti kinematik në 100 të jetë 6.5-7.2 mm ² /s. Pika e ngrirjes -24°C -35°C. Temperatura e flakërimit 230°C-268°C. Indeksi i viskozitetit 90-100
2. Vaj Motorri 2T	Vaj Motorri 2T me keto Specifikime Teknike:API TC, CEC TSC-3 Amballazh 1 litër Densiteti me 15°C të jetë 885-895 kg/m ³ . Përmbajtje uji nuk ka. Viskoziteti në kinematik në 40°C të jetë 120-130mm ² /s. Viskoziteti në kinematik në 100°C të jetë 13-14mm ² /s. Indeksi i viskozitetit 95-115. Pika e ngrirjes -10°C:-15°C. Temperatura e flakërimit min.250-275°C.

<p>3. Vaj motorri 20W-50</p>	<p><u>Vaj motorri SAE 20W50, API CF-4/CF/SG</u></p> <p>Ambalazh 20 litër bidoni dhe 5 litër. Densiteti 15°C të jetë 0.880-0.892 g/cm³. Përmbajtje uji nuk ka. Viskoziteti në 40°C 165-177 mm²/s. Viskoziteti kinematik në 100 të jetë 15-20mm²/s. Pika e ngrirjes -24°C -28°C. Temperatura e flakërimit 238°C-260°C. Indeksi i viskozitetit 90-130.</p>
<p>4. Vaj Kambio SAE 80W90</p>	<p>SAE 80W90 API GL-4, Ambalazh 20 litër bidoni. Densiteti me 15 °C të jetë 0.850-0.895 g/ml. Përmbajtje uji nuk ka. Viskoziteti Min. 40°C të jetë 150-155 mm²/s. Viskoziteti kinematik në 100 °C të jetë 14-15.3 mm²/s. Pika e ngrirjes -24°C-30°C. Temperatura e flakërimit min. 210°C-240°C. Indeksi i viskozitetit 90-110.</p>
<p>5. Vaj Motori 10W-40</p>	<p><u>Vaj motorri 10W-40, SAE API CI-4/SL, ACEA E7/A3/B4.</u></p> <p>Ambalazhi Bidon 20 liter. Densiteti me 15 °C të jetë 860-890 kg/m³. Përmbajtje uji nuk ka. Viskoziteti Min. 40°C të jetë 85-102 mm²/s. Viskoziteti kinematik në 100°C të jetë 11-15 mm²/s. Viskoziteti në 150°C të jetë mPa*s mPa*s≥3.5. Pika e ngrirjes -30°C-40°C. Temperatura e flakërimit min 230-242°C. Indeksi i viskozitetit 120-165. Përmbajtja e hirit % max. 0.070</p>
<p>6. Vaj motorri 5W-30 per RENAULT</p>	<p><u>Vaj motorri 5W-30, API SN/CF, ACEA C2, A5/B5, PSA B71 2290, Fiat 9.55535-S1.</u></p> <p>Ambalazhi Bidon 1 liter dhe 5 liter. Densiteti me 15°C të jetë 849-856 kg/m³. Përmbajtje uji nuk ka. Viskoziteti Min. 40°C të jetë 60-102 mm²/s. Viskoziteti në kinematik në 100°C të jetë 8.2-12mm²/s. Pika e ngrirjes -30°C:-45°C. Temperatura e flakërimit min.230-250°C. Indeksi i viskozitetit 125-170. Përmbajtja e hirit max.0.028-0.07%.</p>

<p>7. Vaj motorri 15W-40</p>	<p><u>Vaj motorri SAE 15W-40, API CF-4/CF/SH, ACEA E-2, ose API CG-4/CF-4/CF/SH, ACEA E-2</u></p> <p>Ambalazhi Bidon 20 litra.</p> <p>Densiteti 15°C të jetë 0.880-0.890 g/cm³.</p> <p>Përmbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti në 40°C 95-130 mm²/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik në 100 të jetë 12-15.7mm²/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -26°C -28°C.</p> <p>Temperatura e flakërimit 230°C-250°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 110-145</p>
-------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<p>8. Vaji Sintetik per Kamio Iveco SAE 75W80SL</p>	<p>Vaji Fully Syntetik per Kamio Iveco SAE 75W80SL, Iveco, Man 341-E3/Z4, Volvo 97305,ZF TE-ML 01L, 02L, 16K, 08</p> <p>Ambalazhi Bidon 20 litra.</p> <p>Densiteti me 15 °C të jetë 0.857-0.860kg/m³.</p> <p>Viskoziteti aparent në -40°C të jetë 65.000 mPas.</p> <p>Viskoziteti kinematik në 100 °C te jete 9.4-9.5 mm²/s.</p> <p>Pika e ngrirjes -40°C-45°C.</p> <p>Temperatura e flakërimit min. 240 -250°C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 150-155.</p> <p>Përmbajtja e hirit % max. 0.03.</p>
------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<p>9. Vaj Renault AJ-8 (kambio)</p>	<p>Vaj KAMIO me specifikime PSA AL-4 ose RENAULT AJ-8,RENAULT AJ0.</p> <p>Ambalazhi Bidon 5 litra.</p> <p>Densiteti me 15 °C të jetë 0.840-0.880 g/ml.</p> <p>Përmbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C të jetë 26-40 mm²/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik në 100 °C të jetë 5.8 -7.8mm²/s.</p> <p>Temperatura e flakërimit min. 180-225 °C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 150-176.</p>
--------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<p>10. Vaj G 004 000 (Grup Timoni)</p>	<p>Vaj per Grup Timoni G004 000, G002 012, G052146,MB 236.3/345.0</p> <p>Ambalazhi Bidon 1 litra.</p> <p>Ngjyra e vajit Jeshile</p> <p>Densiteti me 15 °C të jetë 0.840-0.880 g/ml.</p> <p>Përmbajtje uji nuk ka.</p> <p>Viskoziteti Min. 40°C të jetë 24-40 mm²/s.</p> <p>Viskoziteti kinematik në 100 °C të jetë 5.0 -7.5 mm²/s.</p> <p>Temperatura e flakërimit min. 190-225 °C.</p> <p>Indeksi i viskozitetit 140-176.</p>
-----------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Shënim:Në të gjitha rastet kur është përmendur emri ose markë, njihet barazvleshmëria ose ekuivalent.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.